



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.756/ 8 prot

Datë 31.05.2023

**V E N D I M**  
**Nr.444/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.05.2023 me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “*Saer Medical*” SHPK nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr.REF-64609-04-03-2023, me objekt “*Blerje pajisje mjekesore: Furnizim Vendorsje Aparat Stacionar Grafi Dixhitale me panel detektues dhe me printer lazer/dry lazer për printimin e imazheve radiologjike*”, per nevoja te Spitalit Universitar Obsetrik – Gjinekologjik “*Mbretëresha Geraldinë*”, per vitin 2023”, me fond limit 8.829.600 (tetë milion e tetëqindë e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.04.2023 nga autoriteti kontraktor Spitali Obsetrik Gjinekologjik “*Mbretëresha Geraldinë*”.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr.REF-64609-04-03-2023, me objekt “*Blerje pajisje mjekesore: Furnizim Vendorsje Aparat Stacionar Grafi Dixhitale me panel detektues dhe me printer lazer/dry lazer për printimin e imazheve radiologjike*”, per nevoja te Spitalit Universitar Obsetrik – Gjinekologjik

“Mbretëresha Geraldinë”, per vitin 2023”, me fond limit 8.829.600 (tetë milion e tetëqindë e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.04.2023 nga autoriteti kontraktor Spitali Obsetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Saer Medical” SHPK  
Adresa: Rruga: “Themistokli Gërmenji”, Kati. 1, Tiranë.

Operatori ekonomik “Albaphoto” SHPK  
Adresa: Rruga “Shkëlqim Fusha”, P11. 28, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Spitali Obsetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.  
Adresa: Bulevardi “Zogu i Parë”, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përllëgaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se

ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues “Saer Medical” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5. Operatori ekonomik ankimues “Albaphoto” SHPK nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 04-04-2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr.REF-64609-04-03-2023, me objekt “Blerje pajisje mjekesore: Furnizim Vendosje Aparat Stacionar Grafi Dixhitale me panel detektues dhe me printer lazer/dry lazer për printimin e imazheve radiologjike”, per nevoja te Spitalit Universitar Obsetrik – Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, per vitin 2023”, me fond limit 8.829.600 (tetë milion e tetëqindë e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.04.2023 nga autoriteti kontraktor Spitali Obsetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”

II.2. Në datën 07.04.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3006 dhe me nr. 756/2023 protokollin, e operatorit ekonomik “Saer Medical” SHPK mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me përmbajtje si më poshtë vijon:

*Pika 1, Kapitulli 1, Gjeneratori i rrezeve x specifikimi i kërkuar: Të ketë minimalisht 600 programe anatomike të programueshme kërkesa : të modifikohet ky specifikim në 100 programe anatomikevargumentimi:*

*Ky specifikim është thjesht tipik për një aparat si FDR Smart. e gjejmë këtë specifikim tejet të ekzagjeruar për tipin dhe fluksin e punës së këtij aparati në SUOGJ “Mbretëresha Gerladinë”. Aktualisht asnjë spital që ka marrë pajisje të reja digitale nuk ka 600 programe anatomike të programueshme. Kjo sepse në ditët e sotme, manipulimi i dritareve të imazheve të përfutuara në mënyrë digitale është mjaft i përdorur dhe aty operatori mund të luajë mjaft mirë duke eliminuar këssoj ribërjen e grafisë. Programet anatomikisht të programueshme kanë qenë relevante për pajisjet analoge, ku mundësia për të përsëritur ekspozimin e grafisë ka qenë e madhe. me anë të këtyre programeve, operatorit (sigurisht pasi të kishte përmbushur shumë parakushte si cilësia e filmit, temperatura e solucioneve, distanca e*

shkrepjes, sensitiviteti i skermi të kasetës) i ofrohej mundësia që të kishte të paravendosura kushtet e ekspozimit (kv, mas) duke filluar që nga kockat kraniale e deri te ato talo-crutale.

Pika 2, Kapitulli 5, Tavolinë radiografike specifíkimi i kërkuar: 5.9 Lëvizjet vertikale me pedal këmbë dhe shpejtësi lëvizje të paktën 17 mm/s. 5.10 Tavolinë radiografie me lëvizje vertikale dhe horizontale kërkesa : Të hiqen specifíkimet 5.9 dhe 5.10 argumentimi: Ky aparat do t'iu shërbejë pacientëve Neonatë të cilët shoqërohen nga prindërit dhe po nga këta pozicionohen dhe mbahen të palëvizur në shtrat, sigurisht me orientimin e teknikut/laborantit të imazherisë. këtu nuk kemi të bëjmë me pacientë të cilët janë të pamundur për të lëvizur apo janë të moshuar, apo kur janë me barrela për shkak të traumave dhe ku del nevoja e uljes së shtratit për të mundësuar hipjen dhe pozicionimin e tyre mbi suprinën e shtratit. Në rastin e neonatëve, ky specifíkimi bie poshtë sepse është tërësisht i pavlefshëm dhe bëhet thjesht e vetëm për të kuadruar specifíkimet e ofruar nga Fujifilm.

Pika 3, Kapitulli 5, Tavolinë radiografike specifíkimi i kërkuar : 5.8 Porte të rrotullueshëm për detektorët 35 x 43 cm kërkesa : të hiqet specifíkimi si tipik i fujifilm argumentimi: Nuk ka nevojë të bëhet rrotullimi i detektorit nga portrait në landscape sepse dimensionet e tij arrin të mbulojë të gjithë gjatësinë e neonatit. Ky specifíkimi është tipik në ortopedi dhe jo në maternitet. Ju lutem shihni faqen eeb të fujifilm ku jepet ky specifíkimi : <https://ëëë.fujifilm.com/pl/en/healthcare/x-ray/x-ray-room-dr-solutions/fdr-smart-x>.

Pika 4, Kapitulli 6, Mbajtësi i llambës së rrezeve x specifíkimi i kërkuar: 6.6 Lëvizje horizontale të tubit minimalisht 220 cm kërkesa : të bëhet minimalisht 150 cm ashtu siç edhe e kanë në specifíkimet e tyre pjesa më e madhe e prodhuesve të mirënjohur në botë. argumentimi: Një specifíkimi i tillë është tipik për ambiente urgjencash të traumës ku kërkohet ekspozimi i shpejtë i shumë pjesëve të trupit në një kohë sa më të shkurtër dhe pa patur nevojë për një ripozicionim të pacientit për shkak të pamundësisë së këtij të fundit. në rastin konkret bëhet fjalë për një aparat i cili do t'iu shërbejë fëmijëve të porsalindur dhe një kërkese e tillë për një lëvizje gjatësore të llambës prej 2,2 metra duket mjaft e ekzagjeruar për një pacient të përmasave të një Neonati.

Pika 5, Kapitulli 7, Detektor për radiografi dixhitale specifíkimi i kërkuar: 7.24 Certifikatë për standardin antibakterial të SIAA ISO 22196 kërkesa : të hiqet ky specifíkimi. argumentimi: E njëjta kërkese për certifikatë sanitare, para tre vitesh, ishte vendosur fillimisht edhe në procedurën e prokurimit në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, sepse edhe aty ishte pilotuar për të njëjtin produkt dhe kompani. Pas protestave ky specifíkimi u hoq me turp dhe nuk u mor parasysh sepse u kuptua që ishte për fujifilm i cili, për kronikë u paraqit me çmim mjaft të lartë.

Pika 6 Kapitulli 7 Detektor për radiografi dixhitale specifíkimi i kërkuar: 7.24 softëare duhet të jetë nga i njëjti prodhues që prodhon detektorin dhe bateritë kërkesa : të hiqet ky specifíkimi argumentimi: Përdoruesit i intereson produkti final, pra që pajisja të jetë në gjendje që të ofrojë një softëare aplikimi të mirë i cili të bëjë të mundur shfaqjen dhe manipulimin e duhur të imazheve. Në rast se në produktin e fujifilm si detektori ashtu dhe

programi kanë të njëtin prodhues, kjo nuk e bën aspak më të mirë dhe më të frytshëm këtë softëare. thjesht ky specifikim vendoset aty për të kufizuar konkurrencën dhe avantazhuar fujifilm-in.

Pika 7, Kapitulli 7, Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.12 Kapacitet mbajtës në sipërfaqe të paktën 300 kg kërkesa : të modifikohet ky specifikim me të paktën 100-120 kg argumentimi: Është thellësisht i panevojshëm që të kërkohet një detektor i tillë i cili të ketë një kapacitet të tillë mbajtës. Ky specifikim është i pavend sepse behët fjalë për pacientë neonatë me një peshë gati më të vogël se e vetë detektorit. edhe sikur hartuesit e specifikimeve të pretendojnë që aty do të bëjnë grafi edhe nënat postpartum apo zonja të cilat kanë një patologji të caktuar, përsëri në rastin e tyre detektori do të jetë në poter dhe pacienti nuk do të kenë asnjë pikë kontakti sepse do të shtrihet mbi shtrat. ky specifikim është vendosur ashtu si në pikat e tjera thjesht për të favorizuar fujifilm.

Pika 8, Kapitulli 7, Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.4 Shfaqja e imazheve max për 3 sekonda kërkesa : të hiqet ky specifikim argumentimi: Vijon lista e pafund e specifikimeve sipas fujifilm. Në vetvete shfaqja e një imazhi për 3 apo disa sekonda më shumë nuk kompromenton aspak as cilësinë e diagnozës dhe as fluksin e punës. Për më tepër, pas ekspozimit që i bëhet pacientit, laboranti/tekniku i imazherisë shkon dhe asiston pacientin , pra nuk pengohet aspak procesi.

Pika 9, Kapitulli 7, Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.7 Karikues baterish, ku mund të karikohen të dy bateritë njëkohësisht kërkesa : të hiqet ky specifikim argumentimi: Nuk ka logjikë që të jenë të dy bateritë në karikim e sipër, sepse njëra prej baterive është në detektor kurse tjetra është në karikim

Pika 10, Kapitulli 7, Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.9 Detektori të punojë i kabluar si dhe Ëireless kërkesa : të modifikohet ky specifikim: vetëm Ëireless. argumentimi: Lidhet ngushtësisht me specifikimet teknike të prodhuesit fujifilm ndërkohë që të gjithë prodhuesit e tjerë që teknologjinë Ëireless, përdorin vetëm Ëireless dhe jo me kablo.

Pika 11, Kapitulli 4, Stativ vertikal dhe 5 tavolinë radiografike specifikimi i kërkuar : 4.3 dhe 5.7 Poter që ofron lidhje automatike për detektorin e lëvizshëm për karikim kërkesa : të hiqet ky specifikim argumentimi: Ashtu si edhe në pikën 10, nuk bën sens sepse detektori është i lidhur Ëireless. Kjo është diçka tipike e fujifilm.

Pika 12, Kapitulli 7, Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.10 standardi Ëireless IEE 802.11n kërkesa: të hiqet ky specifikim argumentimi: Pasi kërkon që të ketë komunikim si me kablo ashtu edhe me Ëireless, hartuesit hyjnë në detaje të cilat janë zgjidhje teknologjike specifike e secilit prej prodhuesve dhe ndërhyrja në zgjidhje teknologjike është thjesht favorizim eksplisit i një prodhuesi të caktuar.

*Pika 13, Kapitulli 8, Printer radiografie digjitale lazer/lazer dry specifíkimi i kërkuar: 8.1 Të ketë teknologji printimi lazer/lazer dry kërkesa: Të modifikohet ky specifíkimi në dry laser dhe thermal dry argumentimi: Prej vitesh dy teknologjitë kanë ekzistuar dhe kanë ofruar cilësi të njëjtë imazhi. Fokusimi vetëm te teknologjia lazer eliminon konkurrencën.*

*Pika 14, Kapitulli 8, Printer radiografie digjitale lazer/lazer dry specifíkimi i kërkuar: 8.3 Të ketë kapacitet printimi minimumi 50 mikron kërkesa: Të modifikohet ky specifíkimi në 160 mikron minimumi argumentimi: Ka një mospërputhje teknologjike midis kërkësës për të patur një rezolucion prej 160 mikron për detektorin digital të pajisjes së grafisë, ndërkohë që kur vjen puna te printeri kërkohet 50 mikron. Ky specifíkimi përkon me kërkësën për një printer i cili do të kryejë printime për mammografinë ku kërkohet një rezolucion i lartë, ndërsa këtu nuk është rasti.*

*Pika 15, Kapitulli 8, Printer radiografie digjitale lazer/lazer dry specifíkimi i kërkuar: 8.4 Të ketë të paktën 2 magazina filmi (35x43 cm dhe 20x25 cm) 8.5 Printeri të vijë me të paktën 500 filma me përmasa 35 x43 cm dhe 600 filma me përmasa 26x36 cm kërkesa: Të modifikohet ky specifíkimi i pikës 8.5 në printeri të vijë me të paktën 500 filma me përmasa 35 x43 cm dhe 600 filma me përmasa 26x36 ose 20x25 cm argumentimi: Në rendje e sipër për të vendosur sa më shumë specifíkime të fujifilm edhe te printeri, hartuesit kanë bërë një lapsus teknik duke kërkuar një format filmi 26x36 cm që është tipik i fujifilm sipas edhe këtij Eëbsite të vetë fuji: <https://ëëë.fujifilm.com/pt/en/healthcare/x-ray/dry-imager/drypix-edge>. Ky format mund të ofrohet nga fuji dhe nga askush tjetër. përsëri vallë është rastësi kjo gjë ?kur sheh sasi të kërkuar (500 filma për formatin 35x43 dhe 600 filma për formatin 26x36cm), në pamje të parë nuk të krijon asnjë dyshim. por kur hyn dhe sheh kutitë e fujifilm atëherë kupton më shumë. formati 35x 43 cm përmban 100 fije filmi /kuti ashtu si ádo prodhues tjetër, kurse formati 26x36 cm ka 150 fije filmi dhe rrjedhimisht nuk kërkohen 500, por 600 fije filmi në mënyrë që sasia e kutie të jetë e plotë dhe të sjellin 4 kuti x 150 = 600 fije filmi.*

*Së fundmi, në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.2.kërkohet Certifikatë ISO 9001:2015 mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe në pikën 2.2.3 kërkohet të paraqitet Certifikatë ISO 13485:2016 mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore, për import, eksport, tregtim te materialeve mjekësore/ose/ekuivalent. në asnjë procedurë prokurimi nuk kërkohen të dyja këto Certifikata për ofertuesin, por kërkohet Certifikatë iso 9001:2015 mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalent, e cila mund të jetë ISO 13485:2016.*

*Si përfundim, kërkohet nga ana e autoritetit kontraktor që të reflektojë për specifíkimet e mësipërme teknike në mënyrë që të lejojë një garë të hapur dhe të ndershme. duam t'ju sigurojmë që kërkesa jonë nuk është aspak një kërkese për të kënaqur specifíkimet tona, por për të ruajtur dinjitetin e një gare ashtu si i takon një spitali universitar. ju sigurojmë që produkti që ne përfaqësojmë mban në mënyrë mjaft dinjitoze barrën e punës së një spitali mjaft të rëndësishëm universitar si dhe të disa klinikave private me zë.*

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesve.

II.4. Nëpërmjet shkresës të datës 13.04.2023, protokolluar me tonën me shkresën nr. 756/2 prot., datë 18.04.2023 me objekt “Dërgim Informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni nga operatori ekonomik ankimues “Saer Medical” SHPK.

II.5. Në përfundim të afatit brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në përputhje me nenin 114 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 756/3 prot., datë 20.04.2023, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të të kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike së bashku me procesverbalet e argumentuara për secilin kriter kualifikimi dhe specifikimi teknik, si dhe të jepet informacion i hollësishëm, lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Saer Medical” SHPK.

II.6. Me shkresën nr. 406/13 prot., datë 18.04.2023, protokolluar me tonën nr. 756/4 prot., datë 24.04.2023 me objekt “Mbi dërgimin e vendimit nr. 406/12, datë 18.04.2023”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Saer Medical” SHPK, nëpërmjetë së cilës ka vendosur pranimin pjesërisht me përmbajtje si më poshtë vijon:

*Pika 1, Kapitulli 1 Gjeneratori i rrezeve x specifikimi i kërkuar: Të ketë minimalisht 600 programe anatomike të programueshme kërkesa : të modifikohet ky specifikim në 100 programe anatomikevargumentimi:*

*Lidhur me programet që pretendon OE ulja e numrit të programeve do të thotë më pakë cilësi dhe një standart më i ulët i aparaturës mjekësore duke mos diagnostikuar në kohë problematikat që manifeston produkti dhe do të ulte vleftën e produktit në mënyrë katërcipërore prandaj ky kërkim nuk qëndron. Është në predispozicion e AK që të palnifikojë nevojat e veta në përputhje me standartin e ofrimit të shërbimit.*

*Pika 2, Kapitulli 5, Tavolinë radiografike specifikimi i kërkuar: 5.9 Lëvizjet vertikale me pedal këmbë dhe shpejtësi lëvizje të paktën 17 mm/s, 5.10 Tavolinë radiografie me lëvizje vertikale dhe horizontale kërkesa : të hiqen specifikimet 5.9 dhe 5.10 argumentimi: Ky aparat do t'iu shërbejë pacientëve Neonatë të cilët shoqërohen nga prindërit dhe po nga këta pozicionohen dhe mbahen të pa lëvizur në shtrat, sigurisht me orientimin e teknikut/laborantit të imazherisë. Këtu nuk kemi të bëjmë me pacientë të cilët janë të pamundur për të lëvizur apo janë të moshuar, apo kur janë me barrela për shkak të traumave dhe ku del nevoja e uljes së shtratit për të mundësuar hipjen dhe pozicionimin e*

tyre mbi suprinën e shtratit. në rastin e neonatëve, ky specifikim bie poshtë sepse është tërësisht i pavlefshëm dhe bëhet thjesht e vetëm për të kuadruar specifikimet e ofruar nga fujiilm.

Ankuesi ka parashtruar drejtë kërkesat teknike prandaj edhe në diskutimin me mjekët imazherist të cilët do të përdorin këtë pajisje është e qartë standarti për Neonantin të cilin kërkohet të kryhet shërbimi. Dhe për këtë fakt specifikimi i referohet fjui film në mënyrë të fshehtë.

Pika 3. Kapitulli 5, Tavolinë radiografike specifikimi i kërkuar: 5.8 Poter të rrotullueshëm për detektorët 35 x 43 cm kërkesa : të hiqet specifikimi si tipik i fujiilm argumentimi: Nuk ka nevojë të bëhet rrotullimi i detektorit nga portrait në landscape sepse dimensionimi i tij arrin të mbulojë të gjithë gjatësinë e Neonatit. Ky specifikim është tipik në ortopedi dhe jo në maternitet. ju lutem shihni faqen eeb të fujiilm ku jepet ky specifikim: <https://ëëë.fujiilm.com/pl/en/healthcare/x-ray/x-ray-room-dr-solutions/fdr-smart-x>.

Në pretendimet dhe provat e mbështetura në linkun e sipërcituar përmbushet qëllimi i konkurrencës jo të ndershme dhe me një përmbushje të standartit të shtrembërimit të konkurrencës nga ana e AK nëpërmjet drejtimit të operatorëve ekonomik në një operatorë ekonomik që ka të drejta ekskluzive lidhur me brendin ndërkombëtar fujiilm. Lidhur me këtë pikë kërkesa për këtë pikë pranohet si dhe e tillë të hiqet ky specifikim.

Pika 4, Kapitulli 6, Mbajtësi i llambës së rrezeve x specifikimi i kërkuar: 6.6 Lëvizje horizontale të tubit minimalisht 220 cm kërkesa : të bëhet minimalisht 150 cm ashtu siç edhe e kanë në specifikimet e tyre pjesa më e madhe e prodhuesve të mirënjohur në botë. argumentimi:

Ulja e standartit nga një prag minimal 220 cm dhe në minimalisht 150 cm do të mundet të rriste konkurrencën ndërmjet operatorëve pavarësishtë kësaj për këtë pikë nuk ka argumenta nga ana e OE se përse duhet të pranohet kjo ankes për këtë pikë.

Pika 5 Kapitulli 7, Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.24 Certifikatë për standardin antibakterial të SIAA ISO 22196 kërkesa : të hiqet ky specifikim.

Përdorimi i certifikatave ISO është një standart ndërkombëtar i përdorur në procedurat prokuruese dhe jo vetëm prandaj heqja e kësaj certifikate do të shkaktonte edhe mungesën e standartit të Aparaturës që kërkohet të blihet në funksionin diagnostifikues.

Pika 6 Kapitulli 7 Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.24 softëare duhet të jetë nga i njëjti prodhues që prodhon detektorin dhe bateritë kërkesa : të hiqet ky specifikim argumentimi:

Softëer duhet të jenë funksional dhe të realizojnë qëllimin duke u përqëndruar tek softëeri vetëm i prodhuesit ashtu sic ka përcaktuar e dhe në Gjykata e Lartë konkretisht Kolegji Administrative përbën shkak të diskriminimit të OE pjesëmarrëse dhe do të cënonte standartin e konkurrencës së ndershme ndërmejt ofruesit të mallit. Prandaj ky kërkim i OE qëndron dhe pranohet nga ana e AK.



Pika 7 Kapitulli 7, Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.12 kapacitet mbajtës në sipërfaqe të paktën 300 kg kërkesa : të modifikohet ky specifikim me të paktën 100-120 kg argumentimi:

Duhet të sqarohet ky specifikim teknik nuk është në përputhje me standartin pasi është e qartë që përqendrimi i konkurrencës në një sasi të tillë për pikën 7 Kapitulli 7 do të sillte përqendrimin e konkurrencës tek një operatorë ekonomik i caktuar. Prandaj vendosja e një minimumi nga njësia specialiteti i fushës (100-120 kg) përbën sens pasi nënat që marrin shërbim janë pesha më të vogla.

Pika 8 Kapitulli 7 Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.4 shfaqja e imazheve max për 3 sekonda kërkesa : të hiqet ky specifikim argumentimi:

Specialisti i fushës pjesë e njësies së prokurimit në hartimin e kritereve për një kohë max 3 sekonda është një kërkesë e cila nuk ndikon në konkurrencën e lirë madje i shërben AK në punën e saj për të pasur një efikasitet dhe mirë menaxhim të kushteve të punës nga stafi mjekësor.

Pika 9 Kapitulli 7 Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.7 Karikues baterish, ku mund të karikohen të dy bateritë njëkohësisht kërkesa: të hiqet ky specifikim argumentimi:

Karikimi i dy baterive për këtë rast jemi para kërkesës për sqarim ku në të cilën pasja e dy baterive në karikim nënkupton edhe njëkohësisht përdorimin e tyre ku njësia (personi përgjegjës për prokurimin duhet të jap sqarimet në SPE lidhur me këtë specifikim).

Pika 10, Kapitulli 7 Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.9 Detektori të punojë i kabluar si dhe ëireless kërkesa: të modifikohet ky specifikim : vetëm ëireless. argumentimi:

Përdorimi i këtyre dy portave do të rriste funksionalitetin edhe në rast defektesh të mundshme të njëri nga portave ajo ëirless apo kabulluar. Prandaj ky kërkim nuk qëndron dhe për pasojë rrëzohet.

Pika 11, Kapitulli 4 Stativ vertikal dhe 5 tavolinë radiografike specifikimi i kërkuar : 4.3 dhe 5.7 Poter që ofron lidhje automatike për detektorin e lëvizshëm për karikim kërkesa : të hiqet ky specifikim argumentimi:

Edhe ky kërkim i ankuesit nuk qëndron për faktin se kërkitimi është nëpërmjet dy portave dhe jo vetëm me ëirless siç pretendon ankuese ky pretendim nuk qëndron e për pasojë rrëzohet.

Pika 12, Kapitulli 7 Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.10 standardi ëireless IEE 802.11n kërkesa: të hiqet ky specifikim argumentimi :

Nuk ka ndonjë argument lidhur me këtë standart nga ana e ankuesit e per pasojë manifestohet në mospranimin për këtë kërkim.

Pika 13, Kapitulli 8, Printer radiografie digjitale lazer/lazer dry specifikimi i kërkuar: 8.1 të ketë teknologji printimi lazer/lazer dry kërkesa : të modifikohet ky specifikim në dry laser dhe thermal dry:

Edhe për këtë pikë nuk ka argumente përse duhet të modifikohet ky specifikim e për pasojë shkakton mospranimin e kërkit.

Pika 14; Kapitulli 8, Printer radiografie digjitale lazer/lazer dry specifikimi i kërkuar: 8.3 të ketë kapacitet printimi minimumi 50 mikron kërkesa : të modifikohet ky specifikim në 160 mikron minimumi argumentimi:

Edhe për këtë kërkim të pikës jemi përpara kërkesave për sqarim ku OE mundet të paraqes edhe këtë kërkesë me një specifik më të madhe pasi standarti i vendosur është në minimum duke moskufizuar ofertuesit të paraqesin specifikim më të lartë.

Pika 15, Kapitulli 8, Printer radiografie digjitale lazer/lazer dry specifikimi i kërkuar: 8.4 Të ketë të paktën 2 magazina filmi (35x43 cm dhe 20x25 cm): 8.5 Printeri të vijë me të paktën 500 filma me përmasa 35 x43 cm dhe 600 filma me përmasa 26x36 cm kërkesa: Të modifikohet ky specifikimi i pikës 8.5 në printeri të vijë me të paktën 500 filma me përmasa 35 x43 cm dhe 600 filma me përmasa 26 x 36 ose 20x25 cm argumentimi:

Lidhur me këtë kërkim nga pala ankuese është provuar se përdorimi i këtyre përmasave është tipik i Fujifilmprovuar në linkun e <https://ëëë.fujifilm.com/pt/en/healthcare/x-ray/dry-imager/drypix-edge> për këtë pikë kalon testin e provueshmërisë e për rrjedhojë edhe anulimin e procedurës prokuruese.

Pika 16, në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.2.Kërkohet Certifikatë ISO 9001:2015 Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë dhe në pikën 2.2.3 kërkohet të paraqitet Certifikatë ISO 13485:2016 Mbi Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore, për Import, Eksport, Tregtim te Materialeve Mjekësore/ose/Ekuivalent. Në asnjë procedurë prokurimi nuk kërkohen të dyja këto Certifikata për ofertuesin, por kërkohet Certifikatë ISO 9001:2015 Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë ose Ekuivalent, e cila mund të jetë ISO 13485:2016.

Lidhur me kriteret e veçanta për kualifikim për certifikata ISO janë standarte të mirënjohura dhe kualifikimi i ofertave bëhet në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për kualifikim. **Në nenin 77 të LPP parashikohet:** [...] 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]. Certifikimi ISO 9001:2015 dhe ISO 13485:2016, mundet të kërkohen nga ana e Autoriteteve Kontraktore dhe nuk ka asnjë dispozitë që ndalon në mënyrë taksative që të paraqes më shumë se një certifikim i standartit ISO. Për këtë fakt ky standart ka për qëllim mbrojtjen e kushtit primar të procedural të prokurimit dhe konkretisht të paraqitjes së ofertave pranë AK. Standartet shërbejnë si garanci për të pasur një certifikim në përputhje me kushtet dhe kriteret e tjera të ligjit.

*Duke qenë që në ankesë pala ankues ka paraqitur argumenta të shtrembërimit të konkurrencës konkretisht të fshehtë sipas parashikimit të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” Neni 4 Marrëveshjet e ndaluara [...]1. Ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimit të konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që: a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi; b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet; c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit; [...]. I propozojmë Komisioni Prokurimit Publik që të shprehet me anulimin e procedurës së prokurimit për shkak të shtrembërimit të konkurrencës si dhe me qëllim shmangien e paracaktuar të fituesve. Kjo për faktin se në ligj AK nuk e ka si kompetencë anulimin në rast trajtimi ankese sipas ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Ashtu siç ka përcaktuar Agjencia e Prokurimit Publik në udhërrëfyesin e përbashkët me nr. 88821 Prot datë 20.12.2022 me të APP dhe me nr. 736 Prot., datë 20.12.2022 “Për Prokurimin Publik dhe Mbrojtja e Konkurrencës, integriteti i Procesit të Prokurimit Publik” kreu III.*

#### VENDOSA:

- 1- Të pranojë pjesërisht ankesë e bërë nga shoqëria “SAER MEDICAL” SHPK procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-64609-04-03-2023 me objektin: “Blerje pajisje mjekesore: Furnizim Vendorsje Aparat Stacionar Grafi Dixhitale me panel detektues dhe me printer lazer/dry lazer për printimin e imazheve radiologjike””.*
- 2- Të njoftohet Komisioni i Prokurimit Publik, shoqëria “SAER MEDICAL” SHPK dhe operatorët tjerë të interesuar për këtë vendim.*

II.7. Me shkresën nr. 406/19 prot., datë 27.04.2023, protokolluar me tonën nr. 756/5 prot., datë 02.05.2023 me objekt “Kthim përgjigje shkresës Tuaj nr. 756/3 prot, datë 20.04.2021”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë “Saer Medical” SHPK.

II.8. Në datën 13.04.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi me nr. 801 prot, datë 13.04.2023, e operatorit ekonomik “Albaphoto” SHPK mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me përmbajtje si më poshtë vijon:

*Kompania jone Albaphoto shpk, si nje nga operatoret kryesor ne ofrimin e pasjijeve mjekesore dhe lider ne sektorin e radiologjise si distributore zyrtare e kompanise Fujifilm. Kerkojme modifikimin e nje nga pikave te specifikimeve teknike te kerkuara. Me sakte tek Shtojca 5: Formulari i Specifikimeve Teknike **Pika 5.1: Përmasat e tavolinës min: 230 x 75 cm te behet 220x75 cm.** Meqenese pajisjet e ofruara nga ne plotesojne te gjitha kerkesat, pervec pikes te mesiperme dhe duke marre parasysh qellimin baze te prokurimit publik qe eshte te nxise konkurencen, mendojme ndryshimi i kesaj pike eshte i nevojshem pasi nuk sjelle asnje mangesi klinike pasi gjatesia 220 cm eshte mjaftueshem per shtrirjen e pacientit qe maksimalisht gjatesia e pacenteve eshte 200 cm.*

II.9. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesve.

II.10. Me shkresën nr. 406/9 prot., datë 13.04.2023, protokolluar me tonën nr. 801/2 prot., datë 14.04.2023 autoriteti kontraktor ka depozituar pranë Komisionit Prokurimit Publik infomacionin me objekt “*Mbi plotësimin e të metave të ankesës me nr. 406/6 prot, datë 13.04.2023 me tonën nisur në rrugë postare*”.

II.11. Operatori ekonomik ankimues “*Albaphoto*” SHPK nëpërmjet shkresës me nr. 801/3 prot, datë 14.04.2023, me objekt “*Formular Ankesë*”, ka depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik formularin e ankesave me korrigjimet e të metave.

II.12. Në përfundim të afatit brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në përputhje me nenin 114 te ligjit Nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 801/4 prot., datë 20.04.2023, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të të kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike së bashku me procesverbalet e argumentuara për secilin kriter kualifikimi dhe specifikimi teknik, si dhe të jepet informacion i hollësishëm, lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “*Albaphoto*” SHPK.

II.13. Me shkresën nr. 406/15 prot., datë 24.04.2023, protokolluar me tonën nr. 801/5 prot., datë 24.04.2023 me objekt “*Mbi dërgimin e vendimit nr. 406/14, datë 18.04.2023*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë “*Albaphoto*” SHPK nëpërmjetë të cilës ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.14. Me shkresën nr. 406/18 prot., datë 27.04.2023, protokolluar me tonën nr. 801/6 prot., datë 02.05.2023 me objekt “*Kthim përgjigje shkresës Tuaj nr. 756/3 prot, datë 20.04.2021*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë “*Albaphoto*” SHPK.

II.15. Me shkresën nr. 756/6 prot., datë 16.05.2023 me objekt “*Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur nga operatorët ekonomikë ankimues “*Saer Medical*” SHPK dhe “*Albaphoto*” SHPK për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi i është drejtuar autoritetit kontraktor “*Spitali Obsetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”*” dhe operatorëve ekonomikë “*Saer Medical*” SHPK dhe “*Albaphoto*” SHPK me njoftimin për seancë dëgjimore me datë 18.05.2023, ora 12:30, në ambientet e KPP.

II.15. Në datën 18.05.2023, ora 12:30 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt seancë dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik “Saer Medical” SHPK dhe të autoritetit kontraktor “Spitali Obsetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”. Ndërsa përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankimues “Albaphoto” SHPK nuk u paraqit në vëndin dhe orarin e përcaktuar në shkresën nr. 756/6 prot, datë 16.05.2023, ndaj dhe seanca dëgjimore u zhvillua pa prezencën e tij. Në prani të palëve të sipërcituara, në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik për sqarim në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë nga operatori ekonomik ankimues “Saer Medical” SHPK për sa i përket specifikimeve teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor u zhvillua seanca me përbajtje si vijon:

*Në prezencë të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik ankimues “Saer Medical” SHPK, KPP ndër të tjera, pyet:*

**KPP pyet Autoritetin kontraktor:** *Si janë specifikimet teknike të pajisjeve objekt prokurimi në përputhje me nenin 36 të LPP, pra cilën prej metodave të parashikuar në LPP është mbështetur AK për hartimin e specifikimeve teknike, a ka një standart kombëtar apo ndërkombëtar që AK është mbështetur në hartimin e këtyre specifikimeve teknike, në analizën e studimit të tregut që ka kryer Ak dhe hartimit të specifikimeve teknike a ka vlerësuar që këto specifikime mund të plotësohen nga disa operatorë ekonomik. **Përfaqësuesi i autoritetit kontraktor z. M. T, F. D, sqarojnë se:** Nga ana e Ak janë mbajtur parasysh kriteret e nenit 36 të LPP për hartimin e specifikimeve teknike. Në hartimin e specifikimeve teknike AK i është referuar kërkesave të mjekëve për shkak të nevojave dhe kushteve që ato kanë si dhe kontratave të mëparshme të realizuara nga institucionet e tjera sic është spitali universitar shefqet ndroqi. Vetë autoriteti kontraktor pranon se specifikimet teknike të hartuara për këtë pajisje të drejtojnë vetëm drejte një OE apo prodhuesi të caktuar, ashtu sikurse ka referuar dhe vetë OE ankimues, ndaj dhe këto specifikime shtrembërojnë konkurrencën e lirë sepse plotësojnë vetëm standartet e Fujifilm, duke bërë që të kufizojë konkurrencën.*

**KPP pyet përfaqësuesin e operatorit ekonomik:** *Në lidhje me specifikimet teknike për të cilat ju keni kundërshtuar në këtë procedurë prokurimi, cili është roli në vlerësimin tuaj të këtyre specifikimeve teknike dhe pse nuk janë thelbësore në lidhje me funksionalitetin e pajisjes dhe pse ndryshimi i këtyre specifikimeve teknike nuk çënon qëllimin e e kërkuar nga ana e AK, dhe mbi të gjitha përse këto specifikime teknike ashtu sikurse edhe keni parashtruar në ankesë e kufizojnë konkurrencën.*

**Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. R. C dhe E. C sqarojnë se:** *Gjithacka që ne kemi paraqitur ne këtë prezantim përsa i përketë anës teknike të hartimit të dokumentave kemi vënë re komplet hartimi i specifikimeve teknike kishte një ngjashmëri mjaftë të madhe me një procedurë të mëparshme të një tjetër AK. Ndoshta Ak është nisur nga qëllimi mjaft i mirë për të prokuruar një aparat mjaft serioz i cili i ka rezistuar kohës, por duke mosditur ndoshta që edhe tek ajo procedurë e spitalit shefqet ndroqi ka pasur prob të së njëjtës natyre në lidhje me specifikimet teknike që në sërishit edhe atje i kemi adresuar në kohë. Në vetëvetë kur shikohen këto specifikime duket sikur nuk ka ndonjë gjë të vecantë por duken si numra të ngjashëm por kjo mund të ndodhi që të ketë koncidencë kur hartohet një specifikim sepse asnjëherë nuk mund të jetë një specifikim që ta përmbushin të gjithë OE. Në rastin konkret hartimi i këtyre specifikimeve në tërësi të adreson tek një produkt specifik i një kompanie si Fujifilm, të cilat ne i kemi adresuar si në shpjegimin teknik ashtu dhe me disa ilystrime te*

vogla të cilat i kemi marrë nga ëeb qofte qarkullimin e poterit qoftë për pjesën e programeve anatomike, vumë re edhe cështjen e kërkesës së certifikatës antibakteriale, në vetëvetë të gjithë prodhuesit kryesor boteror nuk e kanë këtë llojë certifikate sepse ajo ju referohet vetëm kërkesës për dedektorin, në vetevete nga ana praktike një pacient qofte nenonat qofte, i moshuar apo moshë mesatare nuk ka rëndësi nëse ky dedektor e ka këtë certifikatë bakteriale kur ndërkohe doreza nuk e ka, shtrati nuk e ka etj, pra kjo është një certifikat që në gjykimin tonë mund të jete një aplikim që ndodhta mund të behet në një vend aziatik për qellime të caktuara. Specifikimi tjetër vetëm për fujin është tek formati i filmave të printerit pra në një aparat radiologjie mbasi ekspozohet pacienti në një ekran del një imazh i një organi të caktuar të pacientit që ky produkt të jetë i finalizuar duhet që të printohet, urojmë ta kalojmë edhe në shpejte pasi në suedin nuk e kanë këto lloje gjeje pasi të gjitha i kanë të digitalizuara. Ky specifikim i kërkuar nga AK për printerin për dy formate filmash, ku një nga formatet është specifik për fujin26 # 36, [pra të gjithë këto gjëra qofte ajo e e numrave anatomik qofte pjesa e pikselave, pjesa e formatit të filmave, qofte dedektori që rrotullohet kanë bërë në një farë mënyre që të përkufizojnë një produkt të caktuar.

**KPP pyet Autoritetin kontraktor:** Për Gjeneratorin e rrezeve x edhe kërkuar të ketë minimalisht 600 programe anatomike të programueshme, pse është kërkuar nga AK që të ketë 600 programe, ndryshimi në një numer me të reduktuar programesh a ndikon në procesin e punës apo funksionalitetin e pajisjes ???

**Përfaqësuesi i autoritetit kontraktor z. M. T, F. D, sqarojnë se:** Të nderuar ky specifikim teknik është kërkuar nga vetë mjekët të cilët për të ushtruar detyrat e tyre u kerkohen dhe specifika të vecanta programesh për të pasur sa më shumë opsione.

**KPP pyet Autoritetin kontraktor:** Cili është roli i këtij programi në funksionalitetin në tërësi të pajisjes në nivel teknik për ta kuptuar dhe sa programe të miratuara mund të kenë protokollet mjekesore të institucionit tuaj që duhet të jenë të ruajtur në mënyrë automatike.

**Përfaqësuesi i autoritetit kontraktor z. M. T, F. D, sqarojnë se:** Të nderuar teknologjia evolon çdo ditë për të përballuar kohën dhe autoriteti të cilit ka ofruar grantin na është kërkuar që të vendosim këto specifika.

**KPP pyet përfaqësuesin e operatorit ekonomik:** Cili është roli i këtij funksionaliteti për pajisjen në tërësi për aq sa ju mund të keni dijeni dhe a ka në dijenin tuaj protokolle që duhet të ruajnë 600 programe dhe si mund të çënojnë në thelb funksionalitetin e pajisjes ky specifikim?

**Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. R. C dhe E. C sqarojnë se:** Specifikimi drejtë një numri 600 apo më shumë programesh është tersisht i pa vend me kushtet e sotme teknologjike, pra e gjejme të nxituar një kërkesë të tillë.

**KPP pyet Autoritetin kontraktor:** Në lidhje me produktin katër poteri që ofron lidhje automatike për dedektorin e levizshëm për karikim kërkohet që të hiqet, cili është roli i këtij specifikimi në funksionalitetin e pajisjes dhe nëse hiqet apo modifikohet a e cenon funksionalitetin e pajisjes.

**Përfaqësuesi i autoritetit kontraktor z. M. T, F. D, sqarojnë se:** Ashtu sic edhe e theksova me pare jam bazuar në hartimin e ketyre specifikimeve teknike në specifikimet teknike që kanë hartuar autoritetet e tjera kontraktore dhe kam dalë në një konkluzion, dhe kjo llogjikë është ndjekur për të gjitha specifikimet teknike.

**KPP pyet përfaqësuesin e operatorit ekonomik:** Cili është roli i këtij specifikimi teknik në vlerësimin tuaj dhe pse ju kerkoni që ky specifikim të hiqet se kufizon konkurrencën.

**Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. R. C dhe E. C sqarojnë se:** Ky specifikim teknik bie poshte per nje arsye te thjeshte sepse vete ne specifikimet teknike te meposhtme kerkohet qe ky dedektor digital te jete i karikueshem dhe madje te jete i pajisur me dy bateri, e thene kjo lloje gjeje edhe e pavend persa kohe kam nje dedektor i cili është i pajisur me baterin e ngarkuar kur vendoset brenda aparatit te kete mundesi qe te lidhet me nje kavo e cila ushqen kete bateridhe ky eshte nje specifikim tipik i fujifilm prandaj kemi kerkuar qe te hiqet, te njejten problematik kemi ngritur dhe me poteri, per te vertetuar kete ne po ju veme ne dispozicion nje fotografi te fujifilm për ta administruar si material per shqyrtimin e ankesës me pershrim FDR smart X fujifil printuar nga adresa fujifilm.

**KPP pyet përfaqësuesin e operatorit ekonomik:** Duke qene se Ak mban te njejtin qendrim ka dicka për të shtuar nga juaj për pretendimet ne ankese me nr. 5, 6, 7, 8, keto specifikime teknike te renditura ne ankese nga ana juaj perse e kufizojne konkurrencen ne vlersimin tuaj dhe ndryshimi i tyre perse nuk ndikon ne funksionalitetin e pajisjes ne teresi.

**Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. R. C dhe E. C sqarojnë se:** Ne vetevete te tera keto specifikime teknike bejne fjale per nje aparat qe eshte fotokopje e kesaj kompanie, poteri qe eshte i lidhshem pjesa e levizjes se krahut te llambes te gjitha se bashku te cojne ne nje produkt te caktuar, te cilat nese ne nuk i ankimojme do jemi subjekt skualifikimi per mospermbushje te tyre. Gjithashtu ky aparat do ti sherbej pacienteve nenonat cka do te thote qe jane per nje pacient qe eshte gati 80 % uje, ndersa keto aparate do ti qendrojne nje ambienti sic eshte trauma, dhe jo per nje foshnje qe eshte i varur nga nje operator mjeksor, por qe jane marre nga nje spital tjetër si specifikime qe kane dhe objekt te ndryshme pune por dhe ne ate rast ne i kemi ankimuar specifikimet.

**KPP pyet përfaqësuesin e operatorit ekonomik:** Për mbajtësin e llambës së rrezeve x specifikimi i kërkuar është lëvizje horizontale të tubit minimalisht 220 cm , ju kerkoni që të modifikohet minimumi 150 cm, përse? Cili eshte roli teknik i ketij specifikimi?

**Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. R. C dhe E. C sqarojnë se:** Normalisht shtatlartesia mesatare e shqiptareve duhet te jete diku tek 170-180 cm, në rastin konkret kerkohet 220. Nese shtrati ku shtrihet pacienti eshte horizontal ktu kemi nje kolon e cila mban llamben eshte thjeshte kjo lloj levizje qe te kete mundesi te mbuloje te gjithë trupin e njeriut. Ne kemi kerkuar qe te jete 150 ne kushtet qe te jete nje aparat mese standart pa asnje lloje specifike te vecante, duke ditur qe kemi te bejme me nje pacient shtatlartesia e te cilit mund te jete me shume se 50 cm ndoshta me pak sac mund te jete nje nenonat ose femijeje cili vjen ne nje moshe pediatrike.

**KPP pyet Autoritetin kontraktor:** Pajisja e kerkuar nga ana juaj per qellim funksionaliteti i sherben vetem femijeve neonat apo i sherben edhe nenave.

**Përfaqësuesi i autoritetit kontraktor z. M. T, F. D, sqarojnë se:** Mesa jam ne dijeni dhe info qe kemi dhe nga mjeket te cilen e kane kerkuar nuk do ti sherbej vetem femijeve por edhe nenave te cilat kane problematika qe u sherben nje pajisje x rei, ndaj sa më shumë specifikime te tilla qe rrisin nr e programeve apo peshes dhe gjatesin e shtratit i sherben me shume maternitetit per te pasur garanci me teper lidhur me semundjet dhe diagnostifikime te ndryshme qe mjeket mund te kerkojne.

**KPP pyet përfaqësuesin e operatorit ekonomik:** Ne lidhje me dedektorin per radiografi digitale shfaqja e imazheve te kerkuara max per 3 sekonda, karikus baterish me dy bateri

*njekohesisht, dedektori te punoje i kabluar dhe ëirles standarti ëirles IEE 802.11, ky është standart kombëtar, ndërkombëtar apo i harmonizuar me standartin nderkombetar.*

***Përfaqësuesi i autoritetit kontraktor z. M. T, F. D, sqarojnë se:*** *Eshte standart kombetar.*

***KPP pyet përfaqësuesin e operatorit ekonomik:*** *Ne lidhje me standartin antibakterial SIAA ISO 22196, ky standart antibakterial eshte kerkuar per te gjithë pajisjen ne tersi apo vetem per element te caktuar te pajisjes, nese eshte kerkuar per element te caktuar te pajisjes cili eshte roli ne funksionalitetin?*

***Përfaqësuesi i autoritetit kontraktor z. M. T, F. D, sqarojnë se:*** *Pas verifikimeve ne internet kemi pare qe ky standarte eshte i vendosur ne keto pajisje dhe ne vendosem qe ta vendosnim duke ju referuar dhe kerkimeve ne internet.*

***Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. R. C dhe E. C sqarojnë se:*** *Pjesen antibakteriale e ezauruam me siper, pjesa e bartjes kapaiteti 300 kg eshte specifikim tipik i kompanis fuji per shfaqjen prej 3 sekonda apo per softëer që të jetë i njëjtë me prodhuesin dhe i baterive, kur këto grupohen te tera bashke si specifikime te cojne ne nje produkt, normalisht softëeri që shërben per vizualizimin e e imazheve te fituara nga aparati nuk ka asnje lloj sensi dhe arsye qe te jete i njejte me prodhuesine baterise apo dedektorit. E njejta gje ndodh dhe me specifikim 3 sekonda.*

***KPP pyet përfaqësuesin e operatorit ekonomik:*** *Në lidhje me pajisjen printer radiografie lazer lazer dry te modifikohet ne dry laser dhe thermal dry, cili eshte roli i këtij specifikimi teknik dhe dhe perse ndryshimi i ketij specifikimi nuk cenon qellimin e kerkuar nga ana e AK?*

***Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. R. C dhe E. C sqarojnë se:*** *Ne vetevete per te pasur nje konkurenc sa me te drejte dhe te ndershme persa i perket pikes qe permendet ju, ne bote sot jane 3-4 prodhues boteror qe ofrojne produkte te kesaj natyre, ne vetevete jane dy teknologji paralele me njera tjetren per rezolucion e arrin te dyja. Per dedektorin digital eshte kerkuar nje rezolucion prej 160 mikron nderkohe printeri este kerkuar me 50 mikron cka do te thote qe nuk shkon sepse materiali i dobet qe do ti shkoje nuk mund tja ngre qartesis materialit sepse ai printon sic i shkon. Ky lloj printeri perdoret zakonisht ne mamografi dhe jo objekt i kesaj proceduredhe kerkohet vetem lazer nderkohe qe me kete konfigurim mund te jete dhe thermal dry duke e permbushur njafte mire, e njejta gje vlen dhe per magazinat e filmave pasi magazina tjetere e kerkuar 26me 36 qe eshte kerkese tipike e fujit qe ka kete format dhe ne kemi kerkuar qe te jete 20-25 ose te vendoset me ose por jo fikse.*

II.16. Në seancën dëgjimore të datës 18.05.2023, ora 12:30, nga operatori ekonomik ankimues “Saer Medical” SHPK, u paraqit si provë dhe u administrua nga Komisioni Prokurimit Publik dokumentacioni me emërtesën “Fuji DI-HL Film 10 x 14 in (26 x 36 cm) / 150 sheets” dhe “FDR Smart X”, i cili u protokollua me shkresën nr. 756/7 prot, datë 18.05.2023 dhe u administrua në fashikullin e shqyrtimit administrativ, si pjesë e tij.

### III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,



## Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Saer Medical” SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës nr. 406/13 prot., datë 18.04.2023, protokolluar me tonën nr. 756/4 prot., datë 24.04.2023 me objekt “Mbi dërgimin e vendimit nr. 406/12, datë 18.04.2023”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë “Saer Medical” SHPK, nëpërmjetë së cilës ka vendosur pranimin pjesërisht me përmbajtje si më poshtë vijon:

*Pika 1, Kapitulli 1 Gjeneratori i rrezeve x specifikimi i kërkuar: Të ketë minimalisht 600 programe anatomike të programueshme kërkesa : të modifikohet ky specifikim në 100 programe anatomikevargumentimi:*

*Lidhur me programet që pretendon OE ulja e numrit të programeve do të thotë më pakë cilësi dhe një standart më i ulët i aparaturës mjekësore duke mos diagnostikuar në kohë problematikat që manifeston produkti dhe do të ulte vleftën e produktit në mënyrë katërcipërore prandaj ky kërkim nuk qëndron. Është në predispozicion e AK që të palnifikojë nevojat e veta në përputhje me standartin e ofrimit të shërbimit.*

*Pika 2, Kapitulli 5, Tavolinë radiografike specifikimi i kërkuar: 5.9 Lëvizjet vertikale me pedal këmbë dhe shpejtësi lëvizje të paktën 17 mm/s, 5.10 Tavolinë radiografie me lëvizje vertikale dhe horizontale kërkesa : të hiqen specifikimet 5.9 dhe 5.10 argumentimi: Ky aparat do t'iu shërbejë pacientëve Neonatë të cilët shoqërohen nga prindërit dhe po nga këta pozicionohen dhe mbahen të pa lëvizur në shtrat, sigurisht me orientimin e teknikut/laborantit të imazherisë. Këtu nuk kemi të bëjmë me pacientë të cilët janë të pamundur për të lëvizur apo janë të moshuar, apo kur janë me barrela për shkak të traumave dhe ku del nevoja e uljes së shtratit për të mundësuar hipjen dhe pozicionimin e tyre mbi suprinën e shtratit. në rastin e neonatëve, ky specifikim bie poshtë sepse është tërësisht i pavlefshëm dhe bëhet thjesht e vetëm për të kuadruar specifikimet e ofruar nga fujifilm.*

*Ankuesi ka parashtruar drejtë kërkesat teknike prandaj edhe në diskutimin me mjekët imazherist të cilët do të përdorin këtë pajisje është e qartë standarti për Neonantin të cilin kërkohet të kryhet shërbimi. Dhe për këtë fakt specifikimi i referohet fjui film në mënyrë të fshehtë.*

*Pika 3. Kapitulli 5, Tavolinë radiografike specifikimi i kërkuar: 5.8 Poter të rrotullueshëm për detektorët 35 x 43 cm kërkesa : të hiqet specifikimi si tipik i fujifilm argumentimi: Nuk ka nevojë të bëhet rrotullimi i detektorit nga portrait në landscape sepse dimensionin e tij arrin të mbulojë të gjithë gjatësinë e Neonatit. Ky specifikim është tipik në ortopedi dhe jo në maternitet. ju lutem shihni faqen eeb të fujifilm ku jepet ky specifikim: <https://ëëë.fujifilm.com/pl/en/healthcare/x-ray/x-ray-room-dr-solutions/fdr-smart-x>.*

*Në pretendimet dhe provat e mbështetura në linkun e sipërcituar përmbushet qëllimi i konkurrencës jo të ndershme dhe me një përmbushje të standartit të shtrembërimit të*

konkurrencës nga ana e AK nëpërmjet drejtimin të operatorëve ekonomik në një operatorë ekonomik që ka të drejta ekskluzive lidhur me brendin ndërkombëtar fujiilm. Lidhur me këtë pikë kërkesa për këtë pikë pranohet si dhe e tillë të hiqet ky specifikim.

Pika 4, Kapitulli 6, Mbajtësi i llambës së rrezeve x specifikimi i kërkuar: 6.6 Lëvizje horizontale të tubit minimalisht 220 cm kërkesa : të bëhet minimalisht 150 cm ashtu siç edhe e kanë në specifikimet e tyre pjesa më e madhe e prodhuesve të mirënjohur në botë. argumentimi:

Ulja e standartit nga një prag minimal 220 cm dhe në minimalisht 150 cm do të mundet të rriste konkurrencën ndërmjet operatorëve pavarësishtë kësaj për këtë pikë nuk ka argumenta nga ana e OE se përse duhet të pranohet kjo ankes për këtë pikë.

Pika 5 Kapitulli 7, Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.24 Certifikatë për standardin antibakterial të SIAA ISO 22196 kërkesa : të hiqet ky specifikim.

Përdorimi i certifikatave ISO është një standart ndërkombëtar i përdorur në procedurat prokuruese dhe jo vetëm prandaj heqja e kësaj certifikate do të shkaktonte edhe mungesën e standartit të Aparaturës që kërkomë të blihet në funksionin diagnostifikues.

Pika 6 Kapitulli 7 Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.24 softëare duhet të jetë nga i njëjti prodhues që prodhon detektorin dhe bateritë kërkesa : të hiqet ky specifikim argumentimi:

Softëer duhet të jenë funksional dhe të realizojnë qëllimin duke u përqëndruar tek softëeri vetëm i prodhuesit ashtu sic ka përcaktuar e dhe në Gjykata e Lartë konkretisht Kolegji Administrative përbën shkak të diskriminimit të OE pjesëmarrëse dhe do të cënonte standartin e konkurrencës së ndershme ndërmejt ofruesit të mallit. Prandaj ky kërkim i OE qëndron dhe pranohet nga ana e AK.

Pika 7 Kapitulli 7, Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.12 kapacitet mbajtës në sipërfaqe të paktën 300 kg kërkesa : të modifikohet ky specifikim me të paktën 100-120 kg argumentimi:

Duhet të sqarohet ky specifikim teknik nuk është në përputhje me standartin pasi është e qartë që përqendrimi i konkurrencës në një sasi të tillë për pikën 7 Kapitulli 7 do të sillte përqendrimin e konkurrencës tek një operatorë ekonomik i caktuar. Prandaj vendosja e një minimumi nga njësia specialiteti i fushës (100-120 kg) përbën sens pasi nënat që marrin shërbim janë pesha më të vogla.

Pika 8 Kapitulli 7 Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.4 shfaqja e imazheve max për 3 sekonda kërkesa : të hiqet ky specifikim argumentimi:

Specialisti i fushës pjesë e njësisë së prokurimit në hartimin e kritereve për një kohë max 3 sekonda është një kërkesë e cila nuk ndikon në konkurrencën e lirë madje i shërben AK në punën e saj për të pasur një efikasitet dhe mirë menaxhim të kushteve të punës nga stafi mjekësor.

*Pika 9 Kapitulli 7 Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.7 Karikues baterish, ku mund të karikohen të dy bateritë njëkohësisht kërkesa: të hiqet ky specifikim argumentimi:*

*Karikimi i dy baterive për këtë rast jemi para kërkesës për sqarim ku në të cilën pasja e dy baterive në karikim nënkupton edhe njëkohësisht përdorimin e tyre ku njësia (personi përgjegjës për prokurimin duhet të jap sqarimet në SPE lidhur me këtë specifikim).*

*Pika 10, Kapitulli 7 Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.9 Detektori të punojë i kabluar si dhe ëireless kërkesa: të modifikohet ky specifikim : vetëm ëireless. argumentimi:*

*Përdorimi i këtyre dy portave do të rriste funksionalitetin edhe në rast defektesh të mundshme të njëri nga portave ajo ëirless apo kabulluar. Prandaj ky kërkim nuk qëndron dhe për pasojë rrëzohet.*

*Pika 11, Kapitulli 4 Stativ vertikal dhe 5 tavolinë radiografike specifikimi i kërkuar : 4.3 dhe 5.7 Poter që ofron lidhje automatike për detektorin e lëvizshëm për karikim kërkesa : të hiqet ky specifikim argumentimi:*

*Edhe ky kërkim i ankuesit nuk qëndron për faktin se kërkitimi është nëpërmjet dy portave dhe jo vetëm me ëirless siç pretendon ankuese ky pretendim nuk qëndron e për pasojë rrëzohet.*

*Pika 12, Kapitulli 7 Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.10 standardi ëireless IEE 802.11n kërkesa: të hiqet ky specifikim argumentimi :*

*Nuk ka ndonjë argument lidhur me këtë standart nga ana e ankuesit e per pasojë manifestohet në mospranimin për këtë kërkim.*

*Pika 13, Kapitulli 8, Printer radiografie digjitale lazer/lazer dry specifikimi i kërkuar: 8.1 të ketë teknologji printimi lazer/lazer dry kërkesa : të modifikohet ky specifikim në dry laser dhe thermal dry:*

*Edhe për këtë pikë nuk ka argumente përse duhet të modifikohet ky specifikim e për pasojë shkakton mospranimin e kërkitimit.*

*Pika 14; Kapitulli 8, Printer radiografie digjitale lazer/lazer dry specifikimi i kërkuar: 8.3 të ketë kapacitet printimi minimumi 50 mikron kërkesa : të modifikohet ky specifikim në 160 mikron minimumi argumentimi:*

*Edhe për këtë kërkim të pikës jemi përpara kërkesave për sqarim ku OE mundet të paraqes edhe këtë kërkesë me një specifik më të madhe pasi standarti i vendosur është në minimum duke moskufizuar ofertuesit të paraqesin specifikim më të lartë.*

*Pika 15, Kapitulli 8, Printer radiografie digjitale lazer/lazer dry specifikimi i kërkuar: 8.4 Të ketë të paktën 2 magazina filmi (35x43 cm dhe 20x25 cm): 8.5 Printeri të vijë me të paktën 500 filma me përmasa 35 x43 cm dhe 600 filma me përmasa 26x36 cm kërkesa: Të modifikohet ky specifikimi i pikës 8.5 në printeri të vijë me të paktën 500 filma me përmasa 35 x43 cm dhe 600 filma me përmasa 26 x 36 ose 20x25 cm argumentimi:*

Lidhur me këtë kërkim nga pala ankuese është provuar se përdorimi i këtyre përmasave është tipik i Fujifilmprovuar në linkun e <https://ëëë.fujifilm.com/pt/en/healthcare/x-ray/dry-imager/drypix-edge> për këtë pikë kalon testin e provueshmërisë e për rrjedhojë edhe anulimin e procedurës prokuruese.

Pika 16, në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.2.Kërkohet Certifikatë ISO 9001:2015 Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë dhe në pikën 2.2.3 kërkohet të paraqitet Certifikatë ISO 13485:2016 Mbi Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore, për Import, Eksport, Tregtim te Materialeve Mjekësore/ose/Ekuivalent. Në asnjë procedurë prokurimi nuk kërkohej të dyja këto Certifikata për ofertuesin, por kërkohet Certifikatë ISO 9001:2015 Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë ose Ekuivalent, e cila mund të jetë ISO 13485:2016.

Lidhur me kriteret e veçanta për kualifikim për certifikata ISO janë standarte të mirënjohura dhe kualifikimi i ofertave bëhet në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për kualifikim. **Në nenin 77 të LPP parashikohet:** [...] 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) **aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]. Certifikimi ISO 9001:2015 dhe ISO 13485:2016, mundet të kërkohej nga ana e Autoriteteve Kontraktore dhe nuk ka asnjë dispozitë që ndalon në mënyrë taksative që të paraqes më shumë se një certifikim i standartit ISO. Për këtë fakt ky standart ka për qëllim mbrojtjen e kushtit primar të procedural të prokurimit dhe konkretisht të paraqitjes së ofertave pranë AK. Standartet shërbejnë si garanci për të pasur një certifikim në përputhje me kushtet dhe kriteret e tjera të ligjit.

Duke qenë që në ankesë pala ankues ka paraqitur argumenta të shtrembërimit të konkurrencës konkretisht të fshehtë sipas parashikimit të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” Neni 4 Marrëveshjet e ndaluara [...]1. Ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që: a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi; b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet; c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit; [...]. I propozojmë Komisioni Prokurimit Publik që të shprehet me anulimin e procedurës së prokurimit për shkak të shtrembërimit të konkurrencës si dhe me qëllim shmangien e paracaktuar të fituesve. Kjo për faktin se në ligj AK nuk e ka si kompetencë anulimin në rast trajtimi ankese sipas ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Ashtu siç ka përcaktuar Agjencia e Prokurimit Publik në udhërrëfyesin e përbashkët me nr, 88821 Prot datë 20.12.2022 me të APP dhe me nr. 736 Prot., datë 20.12.2022 “Për Prokurimin Publik dhe Mbrojtja e Konkurrencës, integriteti i Procesit të Prokurimit Publik” kreu III.

VENDOSA:

- 1- Të pranojë pjesërisht ankesë e bërë nga shoqëria “SAER MEDICAL” SHPK procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-64609-04-03-2023 me objektin: “Blerje pajisje mjekesore: Furnizim Vendorsje Aparat Stacionar Grafi Dixhitale me panel detektues dhe me printer lazer/dry lazer për printimin e imazheve radiologjike””.
- 2- Të njoftohet Komisioni i Prokurimit Publik, shoqëria “SAER MEDICAL” SHPK dhe operatorët tjerë të interesuar për këtë vendim.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Duke qenë se pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimes rezultojnë, se janë pranuar nga autoriteti kontraktor, për këtë arsye KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar të ankesës.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Saer Medical” SHPK mbi specifikimet teknike : “1- Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.24 Certifikatë për standardin antibakterial të SIAA ISO 22196; 2- Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.4 Shfaqja e imazheve max për 3 sekonda; 3- Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.7 Karikues baterish, ku mund të karikohen të dy bateritë njëkohësisht; 4- Stativ vertikal dhe 5 tavolinë radiografike specifikimi i kërkuar: 4.3 dhe 5.7 Poter që ofron lidhje automatike për detektorin e lëvizshëm për karikim; 5- Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.10 standardi Ëireless IEE 802.11n;” për të cilat ka kërkuar heqjen e tyre”, si dhe specifikimet teknike “1- Gjeneratori i rrezeve x specifikimi i kërkuar: Të ketë minimalisht 600 programe anatomike të programueshme; 2- Mbajtësi i llambës së rrezeve x specifikimi i kërkuar: 6.6 Lëvizje horizontale të tubit minimalisht 220 cm; 3- Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.9 Detektori të punojë i kabluar si dhe Ëireless; 4- Printer radiografie digjitale lazer/lazer dry specifikimi i kërkuar: 8.1 Të ketë teknologji printimi lazer/lazer dry; 5- Printer radiografie digjitale lazer/lazer dry specifikimi i kërkuar: 8.3 Të ketë kapacitet printimi minimumi 50 mikron kërkesa; ” për të cilat ka kërkuar modifikimin e tyre, hapjen e diapazonit duke pranuar parametra më të ulët, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” autoriteti kontraktor ka parashikuar specifikimet teknike për artikujt;

*Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.*

*SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

Skicimet, parametrat teknik etj:

	<b>Sistem stacionar radiografie digjitale i përbërë nga:</b>
1	Gjeneratori i rrezeve X
2	Llamba e rrezeve X
3	Kolimatori
4	Stativ vertikal
5	Tavolina radiografike
6	Mbajtës i llambës së rrezeve X

7	<i>Detektor për radiografi dixhitale me ëorkstation dhe monitor</i>
8	<i>Printer lazer ose dry lazer</i>
<b>1</b>	<b><i>Gjeneratori i rrezeve X</i></b>
1.1	<i>Fuqia e gjeneratorit duhet të jetë jo më e vogël se 50 Kë</i>
1.2	<i>Panel kontrolli për përzgjedhje (kV, mA, Time, mAs)</i>
1.3	<i>Të ketë minimalisht 600 programe anatomike te programueshme</i>
1.4	<i>Diapazoni mAs 0.5 - 500 mAs</i>
1.5	<i>Rryma radiografike: 10 - 630 mA</i>
1.6	<i>Sistem vetëdiagnostikimi me error kode</i>
1.7	<i>Tensioni radiografik: nga 40 deri ne 150kV, në hapa 1kV</i>
<b>2</b>	<b><i>Llamba e rrezeve X</i></b>
2.1	<i>Voltazhi i llambës jo me pak se 150kV</i>
2.2	<i>Fuqia e llambës për vatrën fokale maksimale të jetë 75 kë ose më shumë</i>
2.3	<i>Fuqia e llambës për vatrën fokale minimale të jete 25 kë ose më shumë</i>
2.4	<i>Vatra fokale maksimale (fokusi i madh) të jetë 1.2 mm ose më pak</i>
2.5	<i>Vatra fokale minimale (fokusi i vogël) të jetë 0.6 mm ose më pak</i>
2.6	<i>Kapaciteti i nxehtësise së anodës të jetë minimumi 300 kHU</i>
2.7	<i>Te jete i pajisur me sistem ftohes te llampes</i>
<b>3</b>	<b><i>Kolimatori</i></b>
3.1	<i>Pajisje për qendërzimin e rrezes lazer për pozicionim me tregues drite</i>
3.2	<i>Kontroll manual te drites LED me kohëzgjatje jo me pak se 30 sekonda</i>
<b>4</b>	<b><i>Stativ vertikal</i></b>
4.1	<i>I montuar ne dysheme</i>
4.2	<i>Kyçje elektromagnetike</i>
4.3	<i>Poter që ofron lidhje automatike për detektorin e lëvizshem per karikim</i>
4.4	<i>Poter të përshtatshëm për detektorët 35 x 43 cm</i>
4.5	<i>Levizje vertikale të paktën 130 cm</i>
<b>5</b>	<b><i>Tavoline Radiografie</i></b>
5.1	<i>Përmasat e tavolinës min : 230 x 75 cm</i>
5.2	<i>Materiali i sipërfaqes së tavolinës të ketëminimumin e përthithjes së rrezatimit</i>
5.3	<i>Kapaciteti mabjtës minimumi 200 kg</i>
5.4	<i>Levizje laterale prej të paktën 20 cm</i>
5.5	<i>Levizje gjatësore prej të paktën 80 cm</i>
5.6	<i>Lartësia e shtratit min 60 cm</i>
5.7	<i>Poter që ofron lidhje automatike për detektorin e lëvizshëm për karikim</i>
5.8	<i>Poter të rrotullueshëm për detektorët 35 x 43 cm</i>
5.9	<i>Levizjet vertikale me pedal kembe dhe shpejtesi levizje te pakten 17 mm/sek</i>

5.10	<i>Tavoline radiografie me levizje vertikale dhe horizontale.</i>
<b>6</b>	<b><i>Mbajtësi i llambës së rrezeve X</i></b>
6.1	<i>Kolonë e lëvizshme për llambën e rrezeve X e montuar në dysHEME</i>
6.2	<i>Të jetë i mundur rrotullimi i kolonës në hapa 90° (-90° deri në +180°)</i>
6.3	<i>Kendi i rrotullimi të tubit të pakten +/- 120 °</i>
6.4	<i>Të ketë lëvizje vertikale të krahut të tubit të paktën 120 cm</i>
6.5	<i>Të ketë kyçje elektromagnetike</i>
6.6	<i>Levizje horizontale të tubit minimalisht 220 cm</i>
<b>7</b>	<b><i>Detektor për radiografi dixhitale</i></b>
7.1	<i>Me përmasa të paktën 35x43 cm</i>
7.2	<i>Përmasa matrice të paktën 2100 x 2600 pixel</i>
7.3	<i>Nivelet grayscale të paktën 16 bit/pixel</i>
7.4	<i>Shfaqja e imazheve max për 3 sekonda,</i>
7.5	<i>Përmasa pixeli 24un ë24m 160 micron</i>
7.6	<i>Te ketë të paktën 2 bateri, njëra nga të cilat të jetë rezervë</i>
7.7	<i>Karikues baterish, ku mund të karikohen të dy bateritë njëkohësisht</i>
7.8	<i>Bateritë të mbajnë të paktën minimumi 6 orë pune</i>
7.9	<i>Detektori të punojë i kabluar si dhe ëireless</i>
7.10	<i>Standardi ëireless IEE 802.11n</i>
7.11	<i>Rezistenca nga lagështira me standardin IPX6</i>
7.12	<i>Kapacitet mbajtës në sipërfaqe të paktën 300 kg</i>
7.13	<i>Sinjalistika që tregojnë gjendjet e ndryshme të detektorit</i>
7.14	<i>Ëorkstation dhe monitor për përfitim dhe përpunimin e imazheve që ofron të gjitha funksionet DICOM</i>
7.15	<i>Softëari me mundësi për konfigurim të lire të layout-t të filmave 24un ë të njëjtin film mund të printohen disa imazhe.</i>
7.16	<i>Softëari të ketë mundësi për upgrade</i>
7.17	<i>Procesor Core –i5 minimalisht i gjeneratës së 7 ose më i mirë / ekuivalent</i>
7.18	<i>RAM DDR4 të pakten 4 GB</i>
7.19	<i>HDD të pakten 500 GB</i>
7.20	<i>DVD Ëriter</i>
7.21	<i>Ëindoës 10 Pro 64 bit/ ekuivalent</i>
7.22	<i>Monitor LED minimalisht 19 inch</i>
7.23	<i>Softëare duhet të jete nga i njëjti prodhues që prodhon detektorin dhe baterite</i>
7.24	<i>Certifikate për standardin antibakterial të SIAA ISO22196</i>
<b>8</b>	<b><i>Printer radiografie digjitate lazer/lazer DRY</i></b>
8.1	<i>Të ketë teknologji printimi lazer/lazer DRY</i>
8.2	<i>Të ketë shpejtësi printimi të paktën 70 filma/orë për permasen 35 x 43 cm</i>
8.3	<i>Të ketë kapacitet printimi minimumi 50 micron (508 dpi ose 50 micron)</i>



8.4	Të ketë të paktën 2 magazina filmi (35 x 43cm dhe 20 x 25 cm )
8.5	Printeri te vije me te pakten 500 filma me permasa 35 x 43 cm dhe 600 filma 26 x 36cm

*Specifikimi i Materialeve: F-V e pajisjes do te behet prane SUOGJ , “MBRETËRESHA GERALDINË”.*

III.2.2. Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se:

*“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, 2 Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose

prodhuesit.. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën.

Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj". Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrencë të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 "Për prokurimin publik" KE, parashikohet se: *"Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim"*. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" përcaktohet *"Specifikime teknike" janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave*

*për t'u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t'i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”*

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: “*specifikim teknik*” nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni Evropian vs. Mbretëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të parashitrojë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafëruar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të*

*furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): "Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar". Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.*

III.2.4. KPP-ja gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.2.5. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në marrjen e vendimeve mban parasysht, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.”

Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Ndaj për këtë qëllim, Komisioni i Prokurimit Publik, organizoi një seancë dëgjimore midis përfaqësuesve të operatorit ekonomik ankimes, përfaqësuesit të autoritetit kontraktor pjesë e njësisë së prokurimit që është marrë me hartimin e kritereve dhe specifikimeve teknike të procedurës objekt-shqyrtimi. Gjatë seancës në pyetjet drejtuar autoritetit kontraktor, Komisioni gjykoi të nevojshëm sqarimin si mbi metodën e ndërtimit të specifikimeve teknike, por edhe në drejtim të rolit në funksionalitetin e pajisjes të secilës prej specifikimeve teknike të cilat pretendohen nga ankuesi se janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik, si dhe a i shërben funksionalitetit dhe qëllimit të pajisjes hartimi në mënyrë kaq të detajuar i specifikimeve teknike. Gjithashtu,

për ankuesin u drejtuan pyetje në drejtim të provueshmërisë së faktit se përse specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik dhe se si këto të fundit mund të ndikojnë në kufizimin e konkurrencës.

III.2.6 Lidhur me pretendimin e ankimuesit mbi kërkesën e autoritetit kontraktor për në lidhje me specifikimet teknike si **1- Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.24 Certifikatë për standardin antibakterial të SIAA ISO 22196; 2- Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.4 Shfaqja e imazheve max për 3 sekonda; 3- Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.7 Karikues baterish, ku mund të karikohen të dy bateritë njëkohësisht; 4- Stativ vertikal dhe 5 tavolinë radiografike specifikimi i kërkuar: 4.3 dhe 5.7 Poter që ofron lidhje automatike për detektorin e lëvizshëm për karikim; 5- Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.10 standardi Ëireless IEE 802.11n;**” për të cilat ka kërkuar heqjen e tyre”, si dhe specifikimet teknike “**1- Gjeneratori i rrezeve x specifikimi i kërkuar: Të ketë minimalisht 600 programe anatomike të programueshme; 2- Mbajtësi i llambës së rrezeve x specifikimi i kërkuar: 6.6 Lëvizje horizontale të tubit minimalisht 220 cm; 3- Detektor për radiografi dixhitale specifikimi i kërkuar: 7.9 Detektori të punojë i kabluar si dhe Ëireless; 4- Printer radiografie digjitale lazer/lazer dry specifikimi i kërkuar: 8.1 Të ketë teknologji printimi lazer/lazer dry; 5- Printer radiografie digjitale lazer/lazer dry specifikimi i kërkuar: 8.3 Të ketë kapacitet printimi minimumi 50 mikron kërkesa;**. Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konkretisht shtojcës 5 “*Formulari i specifikimeve teknike*”, konstaton se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, si dhe të kërkojë që produktet objekt-prokurimi të jenë të cilësisë maksimale. Komisioni gjykon, se bazuar në specifikat e veçanta të pajisjes objekt prokurimi si dhe bazuar në përdorimin e saj, gjykon, se vlerat fikse të kërkuara për disa nga specifikimet teknike si dhe përcaktimi i disa specifikimeve teknike specifike dhe mbi të gjitha të pa argumentuar janë diskriminuese, dhe kufizojnë në mënyrë të panevojshme konkurrencën. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë. Vlenë të theksojmë se nga ana e autoritetit kontraktor as në në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim pjesë e dokumentave të procedurës objekt prokurimi ashtu edhe gjatë seancës dëgjimore nuk ka argumentuar provuar as ligjërisht as teknikisht se specifikimet e hartuara prej tij nuk e kufizojn pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik dhe nuk i adresojn ato vetëm tek një prodhues ashtu sikurse pretendon operatori ekonomik, gjë të cilën e provoi dhe argumentoi në seancën dëgjimore se specifikimet e hartuara nga autoriteti kontraktor janë të ekzagjuruara dhe

shtrembërojnë konkurrencën pasi i drejtojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës vetëm drejt një prodhuesi dhe se ndryshimi i tyre nuk ndikojn në funksionalitetin e pajisjes dhe në qëllimin e përdorimit të saj. Në këto kushte, me qëllim hapjen e diapazonit të zgjidhjeve të propozuara, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë specifikimet teknike të mësipërme duke i hartuar ato bazuar në funksionalitetin që kërkohet pa përcaktuar përmasa fikse, apo specifikime të cilat i adresojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës vetëm tek një prodhues. Sa më sipër, KPP gjykon se pretendimet e ankimuesit janë të drejta pasi autoriteti kontraktor ashtu sikurse ka pranuar edhe vetë në kthim përgjigjen sa i përketë trajtimit të ankesës ku ka theksuar ndër të tjera se në pretendimet dhe provat e mbështetura në linkun <https://ëëë.fujifilm.com/pl/en/healthcare/x-ray/x-ray-room-dr-solutions/fdr-smart-x>, përmbushet qëllimi i konkurrencës jo të ndershme dhe me një përmbushje të standartit të shtrembërimit të konkurrencës nga ana e AK nëpërmjet drejtimit të operatorëve ekonomik në një operatorë ekonomik që ka të drejta ekskluzive lidhur me brendin ndërkombëtar fujifilm. Lidhur me këtë pikë kërkesa për këtë pikë pranohet si dhe e tillë të hiqet ky specifikim. Për sa më sipër cituam por nisur dhe nga parashtrimet e përfaqësuesve të autoritetit kontraktor në seancën dëgjimore të cilët pohuan se për hartimin e specifikimeve teknike i janë referuar procedurave të ngjashme të realizuara nga institucione të tjera, pa kryer një studim të thelluar të tregut nëse këto specifikime të përdorura ndikojnë në kufizimin e garës dhe shtrembërimin e konkurrencës. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë një diapazon brenda standardit në mënyrë që të mos ketë asnjë element që çon në kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si dhe të evitohet dhe heq përcaktimet dhe specifikimet fikse sikundër në rastin konkret pasi përmasat dhe të dhënat fikse cenojnë konkurrencën dhe janë diskriminuese për operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoritetit kontraktor nuk duhet të vendosë ato specifikime teknike për pajisjet objekt prokurimi të cilat bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në çdo rast specifikimet teknike duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e specifikimeve teknike joproportionale dhe të pajustificuara shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë specifikimet teknike të mësipërme për sa i përket kontestimeve të ngritura nga ana e operatorit ankimues dhe të marrë masa për heqjen e specifikimeve kufizuese dhe përcaktuese, duke parashikuar të dhëna minimale ashtu sikurse parashikohet edhe në LPP, në funksion të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Për këtë arsye, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Saer Medical” SHPK se “*në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.2.kërkohet Certifikatë ISO 9001:2015 mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe në pikën 2.2.3 kërkohet të paraqitet Certifikatë ISO 13485:2016 mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore, për import, eksport, tregtim të materialeve mjekësore/ose/ekuivalent në asnjë procedurë prokurimi nuk*

kërkohen të dyja këto Certifikata për ofertuesin, por kërkohet Certifikatë iso 9001:2015 mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalent, e cila mund të jetë ISO 13485:2016”  
Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.2.3 “Kapaciteti teknik”, , nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.2.3 *Certifikate ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, per import, eksport, tregtim te materialeve mjekesore/ose/ekuivalent. në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.*

III.3.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.3.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.3.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:



“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie

III.3.5. Në nenin 40 pika 5 germa a) dhe pika 6 germa c) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose  
[...]

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët/mallrat/shërbimet që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejta e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar, me qëllim garantimin e realizimit me sukses të objektit të prokurimit. ISO 13485:2016 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një organizatë duhet të demonstrojë aftësinë e saj për të siguruar pajisje mjekësore dhe shërbime të ngjashme që plotësojnë vazhdimisht kërkesat e rregullave të klientit. Organizata të tilla mund të përfshihen në një ose më shumë faza të ciklit jetësor, duke përfshirë hartimin dhe zhvillimin, prodhimin, ruajtjen dhe shpërndarjen, instalimin ose servisimin e një pajisje mjekësore dhe krijimin e zhvillimin ose sigurimin e aktiviteteve shoqëruese (p.sh. mbështetjen teknike). ISO 13485: 2016 mund të përdoret gjithashtu nga furnitorët ose palët e jashtme që ofrojnë produkt, përfshirë shërbimet e lidhura me sistemin e menaxhimit të cilësisë për organizata të tilla. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri objekt ankimi, i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Certifikatës të

mësipërme, është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë përmallrat që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar. Referuar pretendimeve të ankimuesit argumenteve të autoritetit kontraktor si dhe objektit të prokurimit, Komisioni konstaton se objekti i prokurimit ka të bëjë me blerje pajisje mjekësore, ndaj dhe kërkesa e autoritetit kontraktor për ISO 13485: 2016 është në funksion të objektit të prokurimit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Në datën 04-04-2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit *“Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”*, me Nr.REF-64609-04-03-2023, me objekt *“Blerje pajisje mjekësore: Furnizim Vendorsje Aparat Stacionar Grafi Dixhitale me panel detektues dhe me printer lazer/dry lazer për printimin e imazheve radiologjike”*, per nevoja te Spitalit Universitar Obsetrik – Gjinekologjik *“Mbretëresha Geraldinë”*, per vitin 2023”, me fond limit 8.829.600 (tetë milion e tetëqindë e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 18.04.2023 nga autoriteti kontraktor Spitali Obsetrik Gjinekologjik *“Mbretëresha Geraldinë”*.

III.4.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesve.

III.4.2. Me shkresën nr. 406/9 prot., datë 13.04.2023, protokolluar me tonën nr. 801/2 prot., datë 14.04.2023 autoriteti kontraktor ka depozituar pranë Komisionit Prokurimit Publik infomacionin me objekt *“Mbi plotësimin e të metave të ankesës me nr. 406/6 prot, datë 13.04.2023 me tonën nisur në rrugë postare”*.

III.4.3. Operatori ekonomik ankimues *“Albaphoto”* SHPK nëpërmjet shkresës me nr. 801/3 prot, datë 14.04.2023, me objekt *“Formular Ankese”*, ka depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik formularin e ankesave me korrigjimet e të metave.

III.4.4. Në përfundim të afatit brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në përputhje me nenin 114 te ligjit Nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 801/4 prot., datë 20.04.2023, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të të kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike së bashku me procesverbalet e argumentuara për secilin kriter

kualifikimi dhe specifikimi teknik, si dhe të jepet informacion i hollësishëm, lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimes “Albaphoto” SHPK.

III.4.5. Me shkresën nr. 406/15 prot., datë 24.04.2023, protokolluar me tonën nr. 801/5 prot., datë 24.04.2023 me objekt “Mbi dërgimin e vendimit nr. 406/14, datë 18.04.2023”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë “Albaphoto” SHPK nëpërmjetë të cilës ka vendosur mospranimin e ankesës.

III.4.6. Me shkresën nr. 406/18 prot., datë 27.04.2023, protokolluar me tonën nr. 801/6 prot., datë 02.05.2023 me objekt “Kthim përgjigje shkresës Tuaj nr. 756/3 prot, datë 20.04.2021”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë “Albaphoto” SHPK.

III.4.7. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

*“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij”.*

III.4.8. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

*“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.*

III.4.9. Në nenin 110, pikat 1, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

*“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.*

III.4.10. Në nenin 111, pika 1 dhe 4 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1.Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.*

*Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*

*2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.”*

III.4.11. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të ligjit 162/2020 parashikon shprehimisht se: *“1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.*

*2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik”.*

III.4.12. Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

*“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës”.*

III.4.13. Neni 115, “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës”.*

III.4.14. Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në*

*marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.*

*2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:*

*a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;*

*b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;*

*c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;*

*ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;*

*d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.*

III.4.15. Referuar bazës ligjore të sipërcituar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të kontratës (04.04.2023), ka qenë data 11.04.2023. Në këtë kuadër, ankesa pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik është paraqitur në datë 13.04.2023, pra jashtë afateve ligjore të ankimimit.

Në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se ankesa është dorëzuar pranë autoritetit dhe Komisionit më datë 13.04.2023, në zbatim të dispozitës ligjore të sipërcituar barra e provës bie mbi operatorin ekonomik ankimues për të vërtetuar datën e dorëzimit të ankesës si pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit Prokurimit Publik, gjë për të cilën në fashikullin e shqyrtimit administrativ nuk është paraqitur asnjë provë për të vërtetuar faktin e dorëzimit të ankesës në një datë tjetër. Rezulton e provuar se ankesa është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit Prokurimit Publik në datë 13.04.2023, kur ndërkohë duhej të ishte dorëzuar pranë këtij të fundit jo më vonë se në datë 11.04.2023.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, sjell në vëmendje të ankimuesit nenin 111, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *“Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik”*. Në rastin konkret ankesa e operatorit ekonomik ankimues është dorëzuar njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110, pika 1 e LPP i cili parashikon se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e*

*tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë*”.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të kontratës 04.04.2023 dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret data e publikimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është 04.04.2023, ndërkohë ankesa e paraqitur nga ankimuesi pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit Prokurimit Publik përmes shërbimit postar është data 13.04.2023, jashtë afatit 7 ditor të përcaktuar në ligj, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Në rastin konkret rezultoi e provuar, se ankesa është paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit Prokurimit Publik jashtë afateve të parashikuara ligjore të ankimimit.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “*Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji*”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit në autoritet kontraktor, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Saer Medical” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me REF-64609-04-03-2023, me

objekt “Blerje pajisje mjekesore: Furnizim Vendorsje Aparat Stacionar Grafi Dixhitale me panel detektues dhe me printer lazer/dry lazer për printimin e imazheve radiologjike”, me fond limit: 8,829,600.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18-04-2023 nga autoriteti kontraktor, “Spitali Obsetrik Gjinekologjik Mbreteresha Geraldine”.

2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*Albaphoto*” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
  3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
  4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Saer Medical*” SHPK.
  6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Albaphoto*” SHPK.
  7. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
  8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

